

Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 11, 13 dhe 58 shkronja f) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14 , 16 dhe 61 paragrafi 1.6 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01 - 0050862/18, merr:

V E N D I M PËR LIRIMIN NGA DETYRA E DREJTORIT TË DREJTORISË SË INSPEKSIONIT

Neni 1

z. Alban Zeka, lirohet nga detyra e Drejtorit të Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Podujevës.

Neni 2

Lirimi nga detyra e drejtorit sipas nenit 1 të këtij vendimi, bëhet për shkak të performancës jo të kënaqshme në ushtrimin e funksionit përkatës.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:
Të përmendurit
Zyrës së Personelit
QSHQ/Arkivit

02-118102-0071794/24

Nr.prot. 01.11.2024
Podujevë, datë: _____





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 11 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, nenin 19.2 të Ligjit për Vulat në Institucionet e Republikës së Kosovës dhe nenet 14 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr. 01-020/01-0050862/18, merr këtë :

VENDIM

Neni 1

Autorizohet znj. **Filloreta Çitaku**, zyrtare për gjendje civile në Drejtorinë e Administratës për përdorim zyrtar dhe ruajtje të vulës nga kompetenca, fushë veprimtaria dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Administratës, si vijon:

➤ Vula rrethore, teksti:

K.K.

PODUJEVË(në mes të vulës)

DIRECTORATE FOR GENERAL ADMINISTRATION (rrethi i parë)

DREJTORIA PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME (rrethi i dytë)

Dimensioni 40 mm

Neni 2


Autorizimi jepet për kohë të pacaktuar, përveç nëse me ndonjë akt tjetër vendoset ndryshe.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. prot. 02-016/01-0072314/24
Podujevë, datë: 04.11.2024

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 37.2 të Ligjit nr. 02/L-53 për Gjuetinë dhe nenin 16 Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, pas shkëputjes së parakohshme të Kontratës për dhënie në menaxhim me qira të Vendgjuetisë së Përbashkët “Podujeva”, merr:

VENDIM PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËR KONSTATIMIN E GJENDJES NË VENDGJUETINË E PËRBASHKËT “PODUJEVA”

Neni 1

Për konstatimin e gjendjes në Vendgjuetinë e Përbashkët “Podujeva” dhe zbatimin e Planit menaxhues, pas shkëputjes së parakohshme të Kontratës (nr.prot.02-324/01-0060419/17 datë 07.08.2017) për dhënie në menaxhim me qira të Vendgjuetisë së përbashkët “Podujeva” me Vendimin prot. 12-320/01-0048060/24, datë 23.07.2024 të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ngritet Komisioni profesional, në këtë përbërje:

Ymer Hoti, kryesues
Behë Govori, anëtar
Vahide Veseli, anëtare

Neni 2

Komisioni do të bëjë verifikimin e gjendjes në terrenin e Vendgjuetisë së përbashkët “Podujeva” dhe zbatimin e Planit menaxhues konform Ligjit nr. 02/L-53 për Gjuetinë dhe akteve tjera përkatëse nënligjore.

Neni 3

Për punën e kryer, Kryetari i Komunës informohet përmes Drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. prot. 02-020/04-0072731/24
Podujevë, datë: 06.11.2024

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L- 040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 26 paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të datës 06.11.2024, i ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0017955/24 datë 14.03.2024 i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0063865/24, të datës 20.09.2024, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot. 02-400/04-0070473/24, të datës 25.10.2024, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

znj. [redacted] me vendbanim në fshatin Llapashticë e Epërme, Komuna e Podujevës për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve mjekësore, i jepet ndihmë financiare në shumë 1500€.

Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorisë përkatëse.

QSHQ/Arkivit.

znj. Jehona Havolli (njoftohet përmes DSHMS-së).

Nr.prot 02-400/03-0072831/24
Podujevë, datë, 06.11.2024

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulhqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 13, ndërlidhur me nenin 17 shkronjat e) f) dhe nenin 58 shkronjat b) g) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, nenit 14, ndërlidhur me nenin 19 paragrafët 1.5 dhe 1.6, si dhe nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, sipas kërkesës dhe rekomandimit të Kompaninë për Menaxhimin e Mbeturinave në Kosovë, Sh.A. nxjerrë këtë;

V E N D I M **PËR NGRITJEN E GRUPIT PUNUES**

Neni 1

Ngritet Grupi punues në kuadër të projektit “Kosovo Solid West Menagment Program II - IV”, për vazhdimin e funksionimit të deponisë së mbeturinave në fshatin Dumnicë - Komuna e Podujevës, në këtë përbërje:

1. **Bahri Selimi**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, udhëheqës
2. **Fidan Ajvazi**, përfaqësues nga Kompania Regionale e Mbeturinave “Pastrimi”, anëtar
3. **Fidaim Jashari**, përfaqësues nga Kompania Rajonale e Ujësjetjesit, anëtar
4. **Faruk Blakçori**, përfaqësues nga Deponia e mbeturinave në Podujevë, anëtar
5. **Fatri Zhitija**, zëdhënës i Komunës së Podujevës, anëtar

Neni 2

Grupi punues sipas këtij vendimi, bashkëpunon dhe koordinon punët dhe aktivitetet me Kompaninë për Menaxhimin e Mbeturinave në Kosovë, si dhe varësisht nevojave të paraqitura me Drejtorinë, sektorët dhe institucionet tjera relevante, në funksion të implementimit të projektit “Kosovo Solid West Menagment Program II - IV”, për vazhdimin e funksionimit të deponisë së mbeturinave në fshatin Dumnicë të Komunës së Podujevës.

Neni 4

Grupi Punues për punët dhe aktivitetet e kryera informon Zyrën e Kryetarit të Komunës, përmes Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit - udhëheqësit të grupit.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohen:

Anëtarët e Grupit, përmes udhëheqësit
Kompanina për Menaxhimin e Mbeturinave në Kosovë,
QSHQ/Arkivi

Nr.Prot. 02-020/04-0074179/24
Podujevë, datë, 19.11.2024

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 17 shkronja g) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, Ligjin për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera 04/L-027, nenin 44 të Ligjit nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, nenet 16 dhe 19 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, nxjerr,

V E N D I M PËR NGRITJEN E SHTABIT EMERGJENT PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

Neni 1

Ngritët Shtabi Emergjent për mbrojtje dhe shpëtim, për menaxhimin e krizave në nivel Komune, në këtë përbërje:

Shpejtëm Bulliqi , Kryetar i Komunës,	Kryesues
Bahri Selimi , Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit,	Koordinator
Antigona Çitaku - Dibrani , shefe e operatives në Stacionin e Policisë në Podujevë,	anëtare
Shuajb Blakçori , Drejtorja e Administratës,	anëtar
Avni Fetahu , Drejtorja e Arsimit,	anëtar
Leutrim Krasniqi , Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbajtjes së Mjedisit,	anëtar
Fatlum Osmani , Drejtorja e Buxhetit dhe Financave,	anëtar
Adelinë Stublla , Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale,	anëtare
Bajram Bajgora , Qendra Kryesore të Mjekësisë Familjare - Podujevë,	anëtar
Ahmet Ahmeti , U.D. Udhëheqës i Sektorit për Inspeksion në Drejtorinë e Inspeksionit,	anëtar
Kujtim Zhitia , zyrtar për fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi tjera në Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit,	anëtar
Ilaz Hoti , nga Shërbimi i Zjarrfikjes,	anëtar
Fatri Zhitija , Zëdhënës i Komunës,	anëtar
Makfirete Zeka , Kryqi i Kuq i Kosovës – Dega Podujevë,	anëtare

Neni 2

Shtabi Emergjent vepron në funksion të menaxhimit të situatës në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera eventuale (reshje, vërshimeve, përmytjeve, zjarreve, tërmetejeve, rrëshqitjeve të dheut e të tjera të ngjashme) në pajtim me ligjin dhe aktet tjera përkatëse të kësaj natyre si dhe koordinon ngushtë punët dhe aktivitetet me Agjencia e Menaxhimit Emergjent – AME

Neni 3

Për punët dhe angazhimet në terren, Shtabi informon Kryetarin e Komunës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi menjëherë ndërsa shfuqizohet vendimi nr.prot.02-020/04-00o6207/23 i datës 20.01.2023, dhe vendimet tjera pasuese për plotësim ndryshimet e këtij vendimi.

U dërgohet:
Anëtarëve të Shtabit
AME-së (për njoftim)
QSHQ / Arkivit.

Nr.prot. 02-020/04-0074178/24
Podujevë, datë: 14.11.2024

Kryetari i Komunës
Shpejtëm Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L- 040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 26 paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të komisionit të datës 06.11.2024, i ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0017955/24 datë 14.03.2024 i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0063865/24, të datës 20.09.2024, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot. 06-400/04-0074238/24, të datës 15.11.2024, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

znj. [redacted], nga Podujeva për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve mjekësore për vajzën e saj [redacted] si pasojë e plagëve të marra nga sulmi me thikë që ka ndodhur në Komunen e Ferizajt, i jepet ndihmë financiare në shumë 1000€.

Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorisë përkatëse.

QSHQ/Arkivit.

Znj. Arijeta Berisha (njoftohet përmes DSHMS-së).

Nr.prot 02-400/04-0074636/24
Podujevë, datë, 15.11.2024



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot.01-02/01-0050862/18, nenet 3.3; 11.1 dhe 22 të Rregullores (komunale) për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, Vendimin nr.prot.01-413/01-0071612/23, të datës 27.09.2023, për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2024 dhe parashikimet buxhetore 2025-2026, në implementim të projektit "Furnizim me pajisje për Bletë" sipas Ftesë Publike nr.prot.12-320/01-0064143/24 të datës 23.09.2024, në Rekomandim të Komisionit Ad-Hoc të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0065892/24 të datës 01.10.2024 për shqyrtimin edhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve, merr:

V E N D I M

Neni 1

1. Lejohen mjete financiare në shumë totale 37,300.00€, nga e cila 26,110.00€, apo 70% e vlerës financim nga Komuna e Podujevës, si dhe 11,190.00€ apo 30% e vlerës participim nga ana e fermerëve përfitues në projektin e Komunës "Furnizim me pajisje për Bletë", përkatësisht për 34 fermer përfitues, dhe atë për;

- Duplikator elektrik 120 liter,.....17 fermer përfitues
- Koshere të tipit "LR" tre katshe antivaro,.....17 fermer përfitues

2. Mbështetja e fermerëve sipas këtij vendimi bëhet konform kushteve dhe kriterëve të përcaktuara nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Ftesën publike përkatëse për aplikim në projektin "Furnizim me pajisje për Bletë".

Neni 2

Qëllim i realizimit të këtij projekti është promovimi dhe zhvillimi i bujqësisë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Lista përfundimtare e fermerëve të përzgjedhur për implementimin e projektit "Furnizim me pajisje për Bletë", sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e Vendimit kujdeset Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave si dhe Komisionin përkatës sa i përket verifikimit, konstatimit dhe vlerësimit të përmbushjes së kushteve dhe kritereve nga ana e fermerit/es si dhe çështjeve tjera të parapara në Ftesën publike përkatëse.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. Prot. 02-400/01-0074637/24
Podujevë, datë, 18.11.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 11 dhe 58 shkronjat a), b) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 82 paragrafi 3 dhe nenin 102 të Ligjit nr.08/L-197 për zyrtarët publik, nenet 14 dhe 61 paragrafët 1.1) 1.2) dhe 1.7) të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, jep këtë:

A U T O R I Z I M

Autorizohet znj.Adelinë Stublla, Drejtoreshë e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS në Komunën e Podujevës, që në emër të Komunës, të nënshkruaj Kontratat e punës me të punësuarit në Qendrën Rezidenciale-Podujevë, sipas Konkursit nr.prot.13-111/01-0062713/24 të datës 18.09.2024.

*Me këtë Autorizim njoftohen:
Drejtoresha e DSHMS
Njësia e Burimeve Njerëzore
QSHQ / Arkivi*


Nr.Prot. 02-016/01-0075044/24
Podujevë, datë: 20.11.2024

**Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi**





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L- 040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 26 paragrafi 3, nën paragrafët 3.1 dhe 3.2, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0017955/24 datë 14.03.2024 i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0063865/24, të datës 20.09.2024, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot. 06-400/04-0074612/24, të datës 18.11.2024, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

znj. [redacted] nga Podujeva për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve mjekësore të vajzës së saj [redacted] i jepet ndihmë financiare në shumë 500.00€.

Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorive përkatëse.

QSHQ/Arkivit.

znj. Drita Mulliqi (njoftohet përmes DSHMS-së).

Nr. prot. 02-400/03-0075062/24
Podujevë, datë, 20. 11. 2024



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në neneve 13 dhe 58 shkronjat b) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenet 14 dhe 61 paragrafët 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës, nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës, merr:

V E N D I M

Neni 1

z.Alban Shabani, zyrtar në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave-Komuna e Podujevës, caktohet i autorizuar për ndjekjen e trajnimeve dhe certifikim për punët dhe detyrat që kanë të bëjnë me pozitën e zyrtarit kryesor financiar në kuadër të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave.

Neni 2

Caktimi i të përmendurit sipas nenit 1 bëhet me qëllim aftësimin / certifikimit në fushën përkatëse, në mënyrë që të mund të caktohet dhe angazhohet në kryerjen e punëve dhe detyrave të punës të zyrtarit kryesor financiar.

Neni 3

Për zbatimin e vendimit kujdeset Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

U dërgohet:

Të caktuarit

Drejtorisë së buxhetit dhe Financave

Zyrës së personelit

QSHQ / Arkivës

Nr.Prot. 02-020/05-0050862/18
Podujevë, datë: 20.11.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në neneve 13 dhe 58 shkronjat b), g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenet 14 dhe 61 paragrafët 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës, merr:

V E N D I M

Neni 1

1. znj. Jehona Zhjeqi Murati, zyrtare e të hyrave në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave, krahas punëve dhe detyrave nga pozita që mban, **Autorizohet** edhe në kryerjen e punëve dhe detyrave nga pozita e zyrtarit të lartë të buxhetit dhe financave, përkatësisht për kryerjen e punëve dhe detyrave të nën-alokimeve.

2. E Autorizuara po ashtu lejohet për ndjekjen e trajnimeve dhe certifikimit nga fusha e punëve dhe detyrave të nën alokimit në kuadër të pozitës së zyrtarit të lartë për buxhet dhe financa.

Neni 2

Autorizimi i të përmendurës bëhet për shkak të mungesës së zyrtarit/es në pozitën e cekur.

Neni 3

Për zbatimin e vendimit kujdeset Drejtoria e Buxhetit dhe Financave në bashkëpunim dhe koordinim me Zyrën e Personelit.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, dhe i njëjti vlen deri në plotësimin e pozitës së cekur, apo deri në një akti tjetër.

U dërgohet:
Të caktuarës
DBF dhe Zyrës së Personelit
QSHQ/Arkivës

Nr.prot. 04-016/01-0075079/24
Podujevë, 20.11.2024



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot.01-02/01-0050862/18, nenet 3.3; 11.1 dhe 22 të Rregullores (komunale) për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, Vendimin nr.prot.01-413/01-0071612/23, të datës 27.09.2023, për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2024 dhe parashikimet buxhetore 2025-2026, në implementim të projektit "Furnizim me mekanizëm bujqësor" sipas Ftesë Publike nr.prot.12-320/01-0037290/24 të datës 07.06.2024, njoftimin për vazhdimin e afatit për aplikim sipas ftesës publike nr.prot.12-320/01-0046814/24 të datës 18.07.2024, njoftimin për vazhdimin e afatit për aplikim sipas ftesës publike nr.prot.12-320/01-0050312/24 të datës 01.08.2024, njoftimin për vazhdimin e afatit për aplikim sipas ftesës publike nr.prot.12-320/01-0059692/24 të datës 02.09.2024 dhe vazhdimin e ftesës publike nr.prot.12-320/01-0068403/24 të datës 15.10.2024, në Rekomandim të Komisionit Ad-Hoc të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0043346/24 të datës 04.07.2024, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-016-0051363/24 të datës 05.08.2024, për shqyrtimin edhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve, merr:

V E N D I M

Neni 1

1. Lejohen mjete financiare në shumë totale 470.00€, nga e cila 329.00€ apo 70% e vlerës financim nga Komuna e Podujevës, si dhe 141.00€ apo 30% e vlerës së participimit nga ana e fermerëve përfitues në projektin e Komunës "Furnizim me mekanizëm bujqësor", përkatësisht për 1 fermer përfitues, dhe atë për;

- *Frezë për motokultivator 12HP,.....1 fermer përfitues*

2. Mbështetja e fermerëve sipas këtij vendimi bëhet konform kushteve dhe kriterëve të përcaktuara nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Ftesën publike përkatëse për aplikim në projektin "Furnizim me mekanizëm bujqësor".

Neni 2

Qëllim i realizimit të këtij projekti është promovimi dhe zhvillimi i bujqësisë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Lista përfundimtare e fermerëve të përzgjedhur për implementimin e projektit "Furnizim me mekanizëm bujqësor", sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e Vendimit kujdeset Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave si dhe Komisionin përkatës sa i përket verifikimit, konstatimit dhe vlerësimit të përmbushjes së kushteve dhe kritereve nga ana e fermerit/es si dhe çështjeve tjera të parapara në Ftesën publike përkatëse.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. Prot. 02-400/01-0075124/24
Podujevë, datë, 21. 11. 2024



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 63.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nenin 19 parag. 2.2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe nenin 65.1 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, sipas Formularit për deklarimin e konfliktit të interesit nr. prot 02-016/01-0075106/24, datë 21.11.2024 të paraqitur nga z. Leutrim Krasniqi Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, nxjerr:

V E N D I M

Neni 1

1. z. Bahri Selimi, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit autorizohet/caktohet për nënshkrimin e aktit/vendimit lidhur me kërkesën për legalizimin e objekteve shtëpi banimi të z. Afrim Krasniqi, në fshatin Majac, Komuna e Podujevës.
2. Bartja e të drejtës së nënshkrimit të akteve në procesin e legalizimit sipas paragrafit 1 bëhet për shkak të rrethanave të konfliktit të interesit, paraqitur nga z. Leutrim Krasniqi Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, me parashtruesin e kërkesë për legalizim me të cilin është në lidhje familjare (Afrim Krasniqi, është vëllai i babait të Drejtorit).

Neni 2

Zëvendësimi i anëtarit të komisionit bëhet ad hoc, vetëm për rastin e vlerësimit/shqyrtimit të kërkesave nr. prot. 07-350/02-0074742/24 datë 19.11.2024 dhe nr. prot. 07-350/02-0074743/24 datë 19.11.2024, të specifikuar në formularin e deklarimit të konfliktit të interesit, ku i njëjti ka kërkuar të lirohet nga cilësia e zyrtarit për shqyrtim dhe vendosjen sipas kërkesave për shkak të paraqitjes së konfliktit të interesit.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit
QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-020/05-0075352/24
Podujevë, datë: 22.11.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Mbështetur në nenin 58 shkronjat b) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040 dhe nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, jep këtë:

A U T O R I Z I M

I

Autorizohet znj.Makfirete Zeka, zyrtare për kujdesin e personave me aftësi të kufizuara në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-Podujevë, të kryej punët dhe detyrat si dhe të nënshkruaj dokumentacionin nga kompetencat dhe përgjegjësitë e drejtorit të Qendrës për Punë Sociale-QPS.

II

Autorizimi sipas pikës I, ka për qëllim mbulimin e pozitës së cekur dhe mbarëvajtjen e funksionimit sa më efikas të Qendrës për Punë Sociale n'kuadër të Komunës së Podujevës.

III

Autorizimi vlen tre (3) muaj nga dita e nënshkrimit apo eventualisht deri në një akt tjetër administrativ.

IV

E përmendura deponon nënshkrimin për vulosjen e dokumentacionit nga fushveprimtaria e QPS-së.

Nënshkrimi i të autorizuarës _____

I'u dërgohet:

Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Zyrës së Personelit

Të autorizuarës


QSHQ/Arkivit

Nr.Prot. 02-016/01-0075340/24

Podujevë, datë: 21.11.2024

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 11, 13 dhe 58 shkronja f) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14 , 16 dhe 61 paragrafi 1.6 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01 - 0050862/18, merr:

V E N D I M **PËR LIRIMIN NGA DETYRA E DREJTORIT** **TË DREJTORISË SË ADMINISTRATËS**

Neni 1

z. Shuajb Blakçori lirohet nga detyra e Drejtorit të Drejtorisë së Administratës në Komunën e Podujevës.

Neni 2

Lirimi nga detyra e drejtorit sipas nenit 1 të këtij vendimi, bëhet për shkak të angazhimit në funksion tjetër brenda Komunës së Podujevës.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:
Të përmendurit
Zyrës së Personelit
QSHQ/Arkivit

Nr.prot. 02-016/01-0075551/24
Podujevë, datë: 22.11.2024

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 58 shkronja f) dhe 62.2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr.03/L-040, nenet 16, 61 paragrafi 1.6 dhe nenin 64 paragrafi 3 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, merr:

V E N D I M PËR EMËRIMIN E DREJTORIT TË DREJTORISË SË INSPEKSIONIT

Neni 1

z.Shuajb Blakçori, me kualifikim bachelor fakulteti ekonomik-Banka Financa, Kontabilitet: MSC Ekonomi e Gjelbër, Zhvillim i Qëndrueshëm Ekonomik, Energji e Ripërtrishme - South East European University, nga fshati Letanc-Komuna e Podujevës, emërohet;

➤ Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit

Neni 2

I përmenduri në funksionin e cekur emërohet në kohëzgjatje të mandatit të Kryetarit të Komunës, përveç nëse Kryetari i Komunës me vendim të veçantë vendos ndryshe.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:
Të emëruarit
Zyrës së personelit
QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-016/01-0075552/24
Podujevë, datë: 22.11.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja (b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040 dhe nenin 61 par 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës, jep:

AUTORIZIM

Autorizohet z.Shuajb Blakçori, Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Podujevës, të deponojë nënshkrimin në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë për vulosjen e dokumentacionit që ka të bëjë me kompetencat dhe fushë veprimtarinë e Drejtorisë së cekur.

Nënshkrimi i të autorizuarit _____

I dërgohet:

Të autorizuarit
Zyrës së Personelit
QSHQ/Arkivit

Nr.prot. 02-016/01-0075554/24
Podujevë, datë: 22.11.2024

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronjat b) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.prot.01-020/01-0050862/18, jep këtë :

A U T O R I Z I M

Autorizohet z.Shuajb Blakçori, Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Podujevës, të veprojë dhe të nënshkruaj dokumentacionin nga kompetenca dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Administratës, deri në emërimin e Drejtorit të Drejtorisë së cekur, apo eventualisht deri në nxjerrjen e një akti tjetër.

Me këtë njoftohen:
I autorizuari
Zyra e Personelit
QSHQ/Arkivi

Nr.Prot. 02-016/01-0075555/24
Podujevë, datë: 22.11.2024

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi

